

**VENDIM**  
**Nr.725, datë 7.11.2007**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.529, DATË 15.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT E TË MIRATIMIT TË LEJEVE TË NDËRTIMIT TË LINJAVE TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9776, datë 12.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në tekstin, që i bashkëlidhet vendimit nr.529, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**KRITERET DHE PROCEDURAT PËR APLIKIMIN DHE MIRATIMIN E LEJEVE PËR NDËRTIMIN E LINJAVE TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT**

Në tekstin “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Pika 2.3, germa “b” bëhet:

b) Karakteristikat kryesore teknike të linjës së interkonjeksionit, përfshirë edhe vendet e parashikuara për lidhjen e linjës me sistemin elektrik të transmetimit kombëtar dhe me rrjetin e transmetimit të vendeve fqinje.

Pika 2.3, germa “c” bëhet:

c) Kapacitetin neto të transmetimit, që ai kërkon, në raport me kapacitetin e përgjithshëm të linjës së interkonjeksionit, si dhe duke përcaktuar qartë vitet për të cilat kërkohet leja, duke argumentuar se moslëshimi i lejes nga institucionet shtetërore shqiptare, në afatet e kërkuara, do ta bënte realizimin e linjës së interkonjeksionit ekonomikisht joefektiv.

Pika 2.4 hiqet.

Tek pika 4.1, germa “d” dhe paragrafi i dytë i germës “dh”, hiqen.

Pika 4.3 bëhet:

Ministria konkludon mbi dhënien e lejes brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës për dhënien e lejes, pasi të ketë marrë mendimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, si dhe të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Tek pika 4.7, pas paragrafit “iii” shtohet paragrafi “iv”, me këtë përmbajtje:

iv. Kushtin që punimet nuk duhet të fillojnë, në qoftë se kërkuesi nuk paraqet lejet dhe autorizimet e nevojshme për ndërtimin e kësaj linje dhe lidhjen e saj me sistemin energjetik të vendit me të cilin bëhet lidhja, të lëshuara nga autoritetet përkatëse të vendit fqinj, si dhe dokumentacioni përkatës që provon fillimin e ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë elektrike, për transmetimin e së cilës është kërkuar ndërtimi i kësaj linje.

Shpenzimet që kërkuesi ka kryer deri në këtë fazë, përballohen nga ana e tij dhe institucionet publike shqiptare nuk kanë asnjë detyrim.

Tek pika 4.7, shtohet “v”, me këtë përmbajtje:

v. Kushtin që punimet nuk duhet të fillojnë, në qoftë se kërkuesi nuk paraqet marrëveshjen me autoritetet kompetente të të dy vendeve për mënyrat e aksesit apo të përdorimit të linjës së interkonjeksionit.

vi. Kushtin për vlefshmërinë e lejes, që në rast se brenda 12 muajve nga dita e lëshimit të kësaj leje, nuk plotësohen kërkesat e paragrafëve “iv” dhe “v” të mësipërm, leja revokohet.